



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1132 Prot.
10

Pogradec, më 23.03 2023

VENDIM

Nr. 32, DATË 21.03 2023
“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË
PYJORE MOKËR 2

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, të Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtarë”, të kontratës Nr.180/14, datë 03.08.2022 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe subjektit “Joklen & CO Shpk” sh.p.k, Pogradec-Albania, me Nipt **K84322601F** me adresë: “Rruga Rinia, lagjia nr.2, pallat, kat 1, zona kadastrale nr.8581, numur pasurie 4/4, pogradec”, përfaqësuar nga administratori Maliq Misliu, objekt: “Hartim Plani Mbarështimi i dhe menaxhimi ekonomia pyjore Mokër 2”, Bashkia Pogradec me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Ndërmarrjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec që në mbledhjen e datës _____.____.2023 të miratojë:

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore Mokër 2” të hartuar nga Subjekti “Joklen & CO” Shpk me NIPT **K84322601F**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike (Sektori i Shërbimit Pyjor), Drejtoria e Çështjeve Juridike.



3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
5. U shpall sot më datë _____.____.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGERI

